

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 10-2012

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS

Tringë Hyseni

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the **Business Commons**



Universiteti për Biznes dhe Teknologji
Departamenti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

**FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË
KOSOVËS**
Shkalla Bachelor

Tringë Hyseni

Tetor / 2012
Prishtinë



Universiteti për Biznes dhe Teknologji
Departamenti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome
Viti akademik 2009 – 2010

Tringë Hyseni

**FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË
KOSOVËS**

Mentori: Prof. Feim Brava

Tetor / 2012

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Në bazë të praktikave të vendeve tjera të cilat kanë kaluar në periudhën e tranzicionit, problemi kyç i këtij procesi ishte dukuria e korrupsionit, varfërisë dhe efekteve negative të globalizimit. Në këtë punim synojmë që të analizojmë orientimin global strategjik në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës në periudhën e tranzicionit, me qëllim të zvogëlimit të normës së papunësisë, varfërisë dhe anëtarësimin më të shpejtë të Kosovës në UE. Qëllimi i këtij punimi do të jetë një kontribut sa do i vogël që të plotësojë një mungesë të madhe të studimeve që trajtojnë aspektet ekonomike dhe sociale në Kosovë. Zhvillimi i ekonomisë së hapur të tregut e të strukturave demokratike të shoqërisë në Kosovë konsiderohet si domosdoshmëri për stimulimin e aktiviteteve ekonomike. Ky studim synon të përmirësojë nivelin e informimit të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për aspektet ekonomike të problemit të Kosovës, të cilat janë shumë të rëndësishme, por nga ana tjetër, shpeshherë të margjinalizuara.

MIRËNJOHJE/FALËNDERIME

Në radhë të parë falënderoj familjen time e cila më ka përkrahur dhe më ka mundësuar që të studioj në një Univeritet të njohur siç është UBT-ja, me një cilësi mjaft të lartë të nivelit Evropian si për nga ana e kushteve të avancuara me një teknologji më bashkohore, ashtu edhe me ligjerues të shkëlqyer në pikëpamje të mësimdhënies.

Gjithashtu një falënderim të veçantë e meriton profesori i nderuar Feim Brava i cili përkundër angazhimeve të tjera që ka, ka qenë gjithëherë i gatshëm të më përgjigjet në pyetjet e mia dhe të më sygjeroj në lidhje me punimin e temës së diplomës.

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE.....	5
LISTA E TABELAVE.....	6
FJALORI I TERMAVE.....	7
1 HYRJE.....	8
2 SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	9
2.1 Ekonomia e Kosovës	9
2.1.1 Statistikat vitale të ekonomisë	9
2.2 Shkëmbimet tregtare të Kosovës	11
2.2.1 Shpërndarja gjeografike e tregtisë së lirë	11
2.2.2 Tregtia me vendet tjera të botës	13
2.3 Sektorët e ekonomisë së Kosovës	15
2.4 Situata e tanishme në Kosovë dhe në rajon	18
2.4.1 Treguesit kryesor ekonomik dhe rritja e sektorit privat	18
2.4.2 Pasqyra e sektorit të NVM-ve në Kosovë	19
2.4.3 Bizneset e regjistruara në Kosovë	20
2.4.4 NVM-të dhe sektori joformal	22
3 DEKLARIMI I PROBLEMIT.....	23
4 METODOLOGJIA.....	25
5 REZULTATET.....	26
6 DISKUTIME DHE PERFUNDIME.....	27
7 REFERENCAT.....	28

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Eksporti sipas grupeve të produkteve për vitin 2010 (2009)14

Figura 2. Importi sipas grupeve të produkteve për vitin 2010 (2009) 15

LISTA E TABELAVE

<i>Tabela 1. Eksportet e Kosovës sipas grupit të vendeve për vitin 2010</i>	<i>12</i>
<i>Tabela 2. Importet e Kosovës sipas grupit të vendeve për vitin 2010</i>	<i>12</i>
<i>Tabela 3. Partnerët kryesor të Kosovës në eksport dhe import</i>	<i>12</i>
<i>Tabela 4. Ndërmarrjet e regjistruara në Kosovë sipas numrit të punëtorëve – 2010</i>	<i>20</i>
<i>Tabela 5. Ndërmarrjet e regjistruara në Kosovës sipas numrit të ndërmarrjeve 2010</i>	<i>21</i>
<i>Tabela 6. Qarkullimi vjetor sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe pjesës së BPV-së, 2010...</i>	<i>22</i>

FJALORI I TERMAVE

UE – Union Evropian

FMN – Fondi Monetar Ndërkombtar

OBT – Organizata Botërore e Tregtisë

BB – Banka Botërore

NSH – Ndërmarrjet Shërbyese

BE – Bashkimi Evropian

NVP – Ndërmarrjet e Vogla Prodhuese

NVM – Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

BPV – Bruto Prodhimi Vendor

MTI – Ministry of Trade and Industry (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë)

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

ESK – Eksportet e Kosovës

GDP – Gross Domestic Product (Produkti I Brendshëm Bruto)

CEFTA - Central European Free Trade Agreement (Marrëveshja e Evropës Qendrore për tregti të lirë)

CO₂ – Dioksidi i Karbonit

SO₂ – Dioksidi i Sulfurit

NO_x – Monooksidet e Nitrogenit

O₃ - Ozoni

1 HYRJE

Kosova ka probleme të shumta në lidhje me zhvillimin ekonomik të saj. Faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimin ekonomik janë të shumtë duke filluar nga ekonomia e pa qëndrueshme, korrupcioni, papunësia si dhe varfëria si probleme kryesore. Prandaj qëllimi dhe motivimi im në lidhje me përzgjedhjen e temës që ka të bëjë me faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Kosovës ka qenë që të fokusohem dhe të hulumtoj se cilat janë problemet duke marrë për bazë potencialin ekonomik të saj.

Kjo temë fokusohet në temat kryesore siç janë ekonomia aktuale e Kosovës, sektorët e ekonomisë, sfidat ekonomike, papunësia, varfëria, korrupcioni si dhe strategjia e zgjedhjes së këtyre problemeve.

2 SHQYRTIMI I LITERATURES

2.1 EKONOMIA E KOSOVËS

Si vend i rëndësishëm për zhvillimin e biznesit, Kosova ofron një sërë përparësish komparative siç janë: popullsia e re dhe mjaftë mirë e kualifikuar, resurset natyrore, kushtet e volitshme klimatike, infrastruktura e re, politika fiskale me taksat më të ulëta tatimore në rajon, pozita gjeografike me qasje në tregun rajonal të CEFTA-së dhe në atë të Bashkimit Evropian. Kosova përveç se është anëtare e CEFTA-së, në qershor të vitit 2009 është anëtarësuar edhe në FMN (Fondi Monetare Ndërkombëtar) dhe BB (Banka Botërore) dhe aspiron në mekanizma tjerë të fuqishëm ekonomik-financiar si BERZH, Organizata botërore e Tregtisë OBT etj.¹

2.1.1 Statistikat vitale të ekonomisë

- Nr. i banorëve: 1.733.872
- Sipërfaqja: 10,908 km²
- GDP: 4.2 miliardë € (2010 vl)
- GDP shkalla e rritjes ekonomike:4.0% (2010 vl)
- GDP për kokë banori:1909 € (2010 vl)
- GDP - ndarja në sektorë: bujqësia 20%, industria 20%, shërbimet 60%
- Shkalla e papunësisë rreth 40.%
- Shkalla e inflacionit: 3.5% (2010)
- Prodhimi: 5596 miliard kw/h (2010)
- Shpenzimi: 6062 miliard kw/h (2010)
- Shkembimet tregtare
- Eksportet: 295.0 milion € (2010)
- Importet: 2,157 milion € (2010)²

¹ *Ekonomia e Kosovës - Ministria e Punëve të Jashtme - Kosova*

² *Ekonomia e Kosovës - Ministria e Punëve të Jashtme - Kosova, Statistikat vitale të ekonomisë*

- Partnerët kryesor te eksportit: Italia (27.1%), Shqipëria (10.4%), Maqedonia (8.9%), Zvicra (6.0%), Gjermania (5.3%), Kina (5.0%), Turqia (3.2%), Serbia (2.1%), Sllovenia (1.3 %).
- Mallrat që eksportohen: mallra të përpunuara (56%), materiale të papërpunuara (25%), ushqime dhe kafshë të gjalla 6%, lëndë djegëse 4%, makineri e pajisje transporti (3%), etj.
- Partnerët kryesorë të importit: Maqedonia (14.8%), Gjermania (13.0%), Serbia (12.1%), Turqia (7.0%), Kina (6.3%), Italia (4.7%), Shqipëria (3.2%), Sllovenia (3.0%).
- Mallrat që importohen: makineri dhe pajisje transporti (21%), mallra të përpunuara (20%), lëndë djegëse (16%), ushqime dhe kafshë të gjalla (16%), produkte kimike (10%) etj.
- Resurset natyrore: linjiti, zinku, plumbi, ferro-nikeli dhe toka pjellore bujqësore.

Kosova ka një ekonomi të re dhe dinamike. Baza e saj është transformuar nga një ekonomi centraliste, e dirigjuar, në një ekonomi të hapur të tregut, e cila transformimin e saj të thellë e ka përjetuar pas vitit 1999, me çlirimin e Kosovës nga Serbia. Gjatë vitit 2009 gjithësej 114 ndërmarrje shoqërore (NSH), të reja u shpallen për privatizim, duke ngritur kështu në 569 numrin e gjithësej NSH-ve të tenderit për privatizim deri në fund të vitit 2009. E ndodhur në Evropën Juglindore, ekonomia e Kosovës është bërë pjesë e integritimeve ekonomike të këtij rajoni, të cilat ofrojnë mundësitë e zgjerimit të tregut në një hapësirë mjaftë të gjerë. Qellim në vete tashmë është rritja e konkurrencës së kësaj ekonomie, duke rritur kapacitetin e saj eksportues për të zvogëluar deficitin tregtar që Kosova aktualisht ka. Si vend i rëndësishëm për zhvillimin e biznesit Kosova ofron një sërë përparësish komparative si: popullsinë e re dhe mjaftë mirë të kualifikuar, ku mosha mesatare e saj është mjaftë e re, resurset natyrore, kushtet e volitshme klimatike, infrastruktura e re, politika fiskale me taksat më të ulëta tatimore në rajon, pozita gjeografike me qasje në tregun rajonal të CEFTA-së dhe në atë të Bashkimit Evropian.³

³ *Ekonomia e Kosovës - Ministria e Punëve të Jashtme - Kosova, Statistikat vitale të ekonomisë*

2.2 SHKËMBIMET TREGTARE TË KOSOVËS

Kosova gjatë vitit 2010 arriti një vlerë rreth 2.45 miliard euro në shkëmbimet tregtare, e që krahasuar me një vit më parë kishte një rritje të këtyre shkëmbimeve për rreth 17%.

Importet e mallrave të Kosovës gjatë vitit 2009 kapën vlerën rreth 2.16 miliard euro, që paraqet një rritje nominale prej 11.48%.

Eksportet e Kosovës në vitin 2010 ishin 295.9 milionë euro, që paraqet një rritje nominale prej rreth 79% krahasuar me vitin paraprak. Deficiti tregtar u zvogëlua në një shkallë të lehtë nga 91.5% sa ishte në vitin 2009, në 86.3% në vitin 2010 duke arritur përqindjen më të lartë të mbulimit, që nga paslufta me një shkallë prej 13.7%.⁴

2.2.1 Shpërndarja gjeografike e tregtisë së Kosovës gjatë vitit 2010

Partnerët kryesor tregtarë të Kosovës mbeten vendet e Bashkimit Evropian (BE-së) dhe ato të rajonit (anëtare të CEFTA-së).

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së ishin 44.7% të totalit të përgjithshëm, që krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 3.71%. Eksport drejt vendeve të CEFTA-së ishin 24.1% të vlerës totale, krahasuar me vitin paraprak kanë pasur një ulje prej 25.39%, kurse eksportet drejt vendeve të tjera përfshijnë 31.2% të vlerës së përgjithshme.⁵

⁴ *Ekonomia e Kosovës - Ministria e Punëve të Jashtme - Kosova, SHKËMBIMET TREGTARE TË KOSOVËS*


⁵ *Ekonomia e Kosovës - Ministria e Punëve të Jashtme - Kosova, Shpërndarja gjeografike e tregtisë së Kosovës gjatë vitit 2010*

Tabela 1. Eksportet e Kosovës sipas grupit të vendeve për vitin 2010



Importet e Kosovës në vendet e BE-së ishin 38.4% të totalit të përgjithshëm, që krahasuar me vitin paraprak janë rritur për përqindje. Eksport drejt vendeve të CEFTA-së ishin 37.3% të vlerës totale, krahasuar me vitin paraprak kanë pasur një ulje për përqindje, kurse eksportet drejt vendeve të tjera përfshijnë 24.3% të vlerës së përgjithshme.⁶

Tabela 2. Importet e Kosovës sipas grupit të vendeve për vitin 2010



⁶ *Ekonomia e Kosovës - Ministria e Punëve të Jashtme - Kosova*, Eksportet dhe importet e Kosovës sipas grupit të vendeve për vitin 2010

Tabel 3. Partnerët kryesor të Kosovës në eksport dhe import

Nr.	Vendet	Eksporti (000) €	Pjesmarrja në total %	Importi (000) €	Pjesmarrja në total %
1.	Italia	80.193	27.1	100.603	4.7
2.	Shqiperia	30.841	10.4	69.714	3.2
3.	Maqedonia	26.308	8.9	319.313	14.8
4.	Zvicra	17.786	6.0	20.981	1.0
5.	Gjermania	15.587	5.3	280.617	13.0
6.	Kina	14.779	5.0	135.406	6.3
7.	Serbia	3.941	1.3	260.471	12.1

Kosova importon prej vendeve të Bashkimit Evropian pjesën më të madhe të automjeteve, makinerive dhe pajisjeve, produktet e duhanit, të naftës, materiale ndërtimi, produkte ushqimore etj. Eksportet e Kosovës në tregun e BE-27, dëshmojnë një nivel të ulët të konkurrencës, për faktin se përbëhen kryesisht nga mbeturinat e metaleve të ndryshme dhe në masë më të kufizuar nga disa prodhime industriale si feronikeli, materialet e ndërtimit, prodhimet e drurit etj.⁷

2.2.2 Tregtia me vendet tjera të botës

Ndonëse mbi 3/4 e tregtisë së Kosovës është e orientuar drejt vendeve të CEFTA-s dhe atyre të BE-27, Kosova ka shkëmbime tregtare me pjesën më të madhe të vendeve të botës, kryesisht në drejtim të importeve. Ndër këto vlen të përmenden Turqia, nga e cila importohet rreth 7% e vlerës së përgjithshme të importeve dhe Kina, prej se cilës Kosova importon rreth 6.3% të importeve të përgjithshme ndërsa edhe eksportet drejt këtij vendi të largët aziatik përfshijnë 5% të totalit të përgjithshëm të eksporteve kosovare.⁸


⁷ *Ekonomia e Kosovës - Ministria e Punëve të Jashtme - Kosova, Partnerët kryesor të Kosovës në eksport dhe import*

⁸ *Ekonomia e Kosovës - Ministria e Punëve të Jashtme - Kosova, Tregtia me vendet tjera të botës*

Eksportet dhe struktura e mallrave të eksportuara

Pjesën më të madhe të eksportit në vitin 2010, me 51% e zinin mallrat e përpunuara, me vlerë rreth 150.9 milion €, mallra të tjera të pa përpunuara përfshinin 25% të eksporteve me vlerë prej 60.1 milion €. Pjesa tjetër përfshinë; ushqime dhe kafshë të gjalla 6%, lëndë djegëse 4%, makineri dhe pajisje 3% , pije e duhan 2%, dhe produkte kimike 1%, e vlerës së përgjithshme të eksportit. Më poshtë janë paraqitur edhe krahasimet me vitin 2010.⁹

Figura 1. Eksporti sipas grupeve të produkteve për vitin 2010 (2009)





Importet dhe struktura e mallrave të importuara

Importet në vitin 2010 përbëheshin nga makineri e pajisje transporti 21% me vlerë rreth 453.1 milion €, mallrat e përpunuara 20% me vlerë prej 431.5 milion €, ushqime dhe kafshë të gjalla 16% ose 345.2 milion €, lëndë djegëse 16% apo 345.2 milion €, produkte kimike 10% me 215.8 milion €, mallra të tjera të përpunuara 9% me 194.2 milion €, pije dhe duhan 5% me 107.9 milion €, materiale të papërpunuara 3% me vlerë rreth 64.7 milion €, yndyrna bimore dhe shtazore 1% apo 21.6 milion €. ¹⁰

⁹ *Ekonomia e Kosovës - Ministria e Punëve të Jashtme - Kosova*, Eksportet dhe struktura e mallrave të eksportuara

¹⁰ *Ekonomia e Kosovës - Ministria e Punëve të Jashtme - Kosova*, Importet dhe struktura e mallrave të importuara

Figura 2. Importi sipas grupeve të produkteve për vitin 2010 (2009)



2.3 SEKTORËT E EKONOMISË SË KOSOVËS

Energjia dhe Minierat - Kosova ka pasuri të mëdha nëntokësore, me 14,700 milion ton, ajo zë vendin e pestë në botë për rezerva linjtit prej të cilit ajo edhe prodhon sasinë më të madhe të energjisë elektrike. Kosova gjatë vitit 2008 ka prodhuar 4738 miliard kw/h dhe ka shpenzuar 5156 miliard kw/h energji elektrike.

Rezervat e këtij minerali që përdoret si burim kryesor i prodhimit energjetik në Kosovë vlerësohet se do të zgjasin për 650 vjet të tjera, me ritmin e nxjerrjes momentale.

Rezerva linjiti janë të shpërndara edhe në rajonin e Dukagjinit dhe atë të Drenicës, por nxjerrja e mineralit momentalisht është kufizuar vetëm në Kosovën qendrore. Pos linjtit, Kosova është e pasur edhe me zink, plumb, ari, kadmium dhe bismut, boksit, nikel etj. Kultura e nxjerrjes së linjtit daton që nga koha romake, nxjerrja moderne e mineraleve në Kosovë fillon në vitet '30, të shekullit të kaluar, me themelimin e Kompleksit të Trepçës.

Bujqësia dhe Blegtoria - Kosova është e pasur me tokë bujqësore, 53% të sipërfaqes totale janë tokë e punueshme. Momentalisht sektori i bujqësisë kontribuon vetëm 19% në NVP-në e përgjithshme dhe 15% në vlerën e eksportit. Procedimi i ushqimit në Kosovë tradicionalisht është udhëhequr nga ndërmarrjet shoqërore, derisa sot këto janë jo-aktive; kompani të reja private kanë filluar të operojnë në këtë fushë. Pjesa më e madhe e këtyre kompanive janë të vogla dhe nuk janë ende të afta për të mbuluar pjesën më të madhe të kërkesave në treg.

Vreshtaria - Rritja e rrushit dhe prodhimi i verës është një traditë e vjetër në Kosovë. Gjatë viteve të arta, industria e verës vetëm në Rahovec ka pasur kapacitet prodhimi deri në 50 milion litra në vit. Në vitin 1989, eksporti i verës së Rahovecit ka arritur në 40 milion litra që kryesisht janë shpërndarë në tregun gjerman. Pas privatizimit të një pjese të vreshtave dhe fabrikës së verërave në Rahovec, është arritur të mbulohet një pjesë e mire e tregut vendor e po ashtu ka gjetur plasman të suksesshëm në tregun ndërkombëtar, posaçërisht në atë evropian.

Ndërtimtaria - Viteve të fundit industria e ndërtimit është bërë njëri ndër sektorët më të rëndësishëm në ekonominë kosovare. Ky sektor vazhdon të jetë një potencial shumë i madh ekonomik për Kosovën, duke marrë parasysh nevojën për ndërtime të vendbanimeve të reja dhe infrastrukturës rrugore. Vet Qeveria e Kosovës ka vendosur për qëllim që të lidhë vendin me korridoret më të rëndësishme në Maqedoni, Shqipëri dhe Serbi.

Industria e tekstit - Tekstili ka qenë sektori i dytë për nga madhësia në Kosovë, ndërsa në kulmin e zhvillimit të saj 15 ndërmarrjet shoqërore të prodhimit të tekstit kanë punësuar më shumë se 1,000 njerëz dhe kanë arritur shitje deri në 35 milion euro.

Përkundër zhvillimeve të fundit në rajon, që kanë prishur lidhjet e tregtisë, analizat ndikojnë se nga 55 deri në 65 milionë euro mund të arrihen me eksportim, në rast të rikthimit të këtyre lidhjeve. Në këtë sektor ka mjaft hapësirë për investitorë që edhe njëherë Kosova të prodhojë rroba të përfunduara nga tekstili i prodhuar në rajon.

Turizmi - Potenciali turistik i Kosovës lidhet ngushtë me pozitën gjeografike të Kosovës, e rrethuar nga të gjitha anët me male dhe në qendër të Ballkanit, vendi ka potencial për turizëm dimëror. Malet në jug të Kosovës, vendpushimet si Brezovica dhe Malet e Sharrit janë mundësi shumë të mira dhe interesante për investitorët. Momentalisht vendpushimi i Brezovicës përfshinë tre hotele, dy restorante dhe nëntë ski-lifte që momentalisht janë pronë shoqërore. Përpos Brezovicës, vend tjetër malor që shfrytëzohet për turizëm dimëror janë Bjeshkët e Nemuna, të vendosura në perëndim të Kosovës. Mendohet se ky lokacion turistik ka potencial për të pranuar deri në 30,000 vizitorë turistik. Potencialin e këtij rajoni veç më kanë filluar të shfrytëzojnë kompani të vogla private që kanë ndërtuar komplekse private në fshatin Bogaj.

Sistemi bankar - Sektori bankar në Kosovë, vlerësohet ndër sektorët me performancën më të mirë në ekonomi. Depozitat bankare dhe kreditë janë në rritje, ndërsa shkalla e shërbimeve financiare po shënon zgjerim. Banka Qendrore e Kosovës i ka autoritetin të licencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë institucionet financiare në territorin e Kosovës. Sektori i bankave komerciale përbëhet prej 8 bankave. Bankat komerciale ofrojnë pakon e plotë të shërbimeve bankare, përfshirë: huat, garancitë, llogaritë rrjedhëse, llogaritë e kursimeve, depozitat e afatizuara, transferet në vend dhe jashtë tij, si dhe shërbimet për ruajtjen e gjësëndeve me vlerë e që në vitin 2009, këto banka rritën kapitalin aksionar prej 9.3% duke u ngritur në nivel prej 159.4 milion €. Sektori bankar, që përfaqëson pjesën më të madhe të sektorit financiar të Kosovës, u karakterizua me një rritje të shkallës së ndërmjetësimit financiar. Në vitin 2009, kreditë e lëshuara nga sektori bankar arritën vlerën 1.4 miliard euro, e cila është për 7.7% më e lartë se në vitin paraprak. Struktura e kredive vazhdon të jetë e ngjashme dhe dominohet nga kreditë në sektorin e tregtisë. Sa i përket kohëzgjatjes, kreditë më afatgjate vazhdojnë të ngritin pjesëmarrjen e tyre në gjithësej portofolin. Një rritje signifikante është vërejtur edhe tek depozitat të cilat arritën vlerën 1.74 miliard euro, që është për 21% më e lartë se në vitin paraprak.¹¹

¹¹ *Ekonomia e Kosovës - Ministria e Punëve të Jashtme - Kosova, SEKTORËT E EKONOMISË SË KOSOVËS*

2.4 SITUATA EKONOMIKE E TANISHME NË KOSOVË DHE NË RAJON

Mesatarja e rritjes reale të Bruto Produktit Vendor (BPV) në Kosovë për vitet 2006-2009 ishte 4.8%. Dëshmit tregojnë se vendimi i qeverisë i vitit 2008 për rritje të nivelit të investimeve publike mbi 120% ka qenë shtytës kryesor për rritjen ekonomike. Veç kësaj, kjo zhvendosje e resurseve të ndara për investime publike është dëshmuar si stimulim për ekonominë në vitin 2009 dhe mbajtur mundësitë për gjenerim të rritjes mbi 4% në një kohë kur shumica e vendeve regjionale janë përballur me rënie ekonomike. Për shkak të nivelit relativisht të ulët të integritit të Kosovës në ekonominë globale dhe politikave të dobëta fiskale, ekonomia e saj ka qenë dukshëm e mbrojtur nga kriza ekonomike globale. Ekonomia është rritur në vitin 2009 dhe ka vazhduar rritjen në vitin 2010. Rritja ekonomike me e madhe ka qenë e shtyrë nga shpenzimet qeveritare, ndërsa bilanci tregtar i jashtëm ka mbetur i lartë (Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën për vitin 2010). Bazuar në raportet e Bankës Botërore, një pjesë e madhe e progresit ekonomik të kohëve të fundit ka qenë i bazuar në ndihmën e donatorëve dhe remitancat, të cilat nuk mund të jenë bazë për strategji të qëndrueshme ekonomike.¹²

2.4.1 Treguesit kryesor ekonomik dhe rritja e sektorit privat

Treguesit makroekonomik sugjerojnë se ekonomia e Kosovës ka pasur progress gjatë vitit 2010. Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2010 ka shënuar rritje prej 4.0% në krahasim me vitin 2009, që ishte rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme dhe të jashtme. Bazuar në të dhënat e importit dhe të sektorit financiar, investimet private kanë shënuar rënie prej 0.9%. Përkundër kësaj, kontributi publik financiar në kërkesën agregate ka vazhduar të jetë pozitiv. Ndikimi i shpenzimeve kapitale në totalin e investimeve ka qenë më i rëndësishme se sa në vitin e kaluar, ku është shënuar një rritje prej 13.7% e që ka ndikuar në rritje në totalit të investimeve për 4.1% në krahasim me vitin 2009.¹³

¹² STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË NVM-ve NË KOSOVË 2012-2016- SITUATA EKONOMIKE E TANISHME NË KOSOVË DHE NË RAJON

¹³ STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË NVM-ve NË KOSOVË 2012-2016- Treguesit kryesor ekonomik dhe rritja e sektorit privat

2.4.2 Pasqyra e sektorit të NVM-ve në Kosovë

Ekonomia e Kosovës që nga viti 1999 ka qenë kryesisht e shtyrë nga ndihma ndërkombëtare, sektori publik dhe remitancat (BB, 2010). Roli i sektorit privat, e posaçërisht i NVM-ve ka qenë relativisht i dobët. Pavarësisht kësaj, Kosova është ende në fazën e tranzicionit ku ndërmarrësia dhe krijimi i bizneseve të vogla pritet të luaj rol thelbësor në rrugën drejt një ekonomie moderne të tregut të lirë dhe si rrjedhim edhe drejt zhvillimit dhe rritjes ekonomike. Kosova vuan nga mos bilanci i pagesave ku importet dominojnë dukshëm eksportet. Kjo është kryesisht për shkak të faktit që NVM-të e Kosovës nuk janë konkurrense në nivel ndërkombëtar. NVM-të eksportuese të dobëta, pengojnë kontributin e mëtutjeshëm të NVM-ve në BPV, krijim të vendeve të punës dhe në rritje ekonomike. Eksportet dominohen nga metalet dhe mineralet bazë të prodhuara nga kompanitë e mëdha. Për shkak të mjedisit jo të favorshëm për biznes dhe në mungesë të kultures kreative të ndërmarrësisë, Kosova ka mungesë të firmave inovative me rritje të shpejtë, të cilat janë kontribuesit kryesor në krijimin e vendeve të punës në ekonominë e zhvilluara perëndimore.

Mbi 50% e të gjitha NVM-ve operojnë në sektorin tregtar që karakterizohet me investime të vogla dhe joproductive. Ky model i pasuar me qasjen kopjuese “edhe unë” të bizneseve të reja, kufizon kapacitetin e sektorit të NVM-ve për gjenerimin e vendeve të punës. Në kuptim të zhvillimit të politikave, raporti “Indeksi i Politikave për NVM 2009” tregon se Kosova për disa arsye të ndryshme, ende është në fazën e kompletimit të kërkesave themelore institucionale, ligjore dhe rregullative që kanë të bëjnë me politikat e NVM-ve.¹⁴

¹⁴ STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË NVM-ve NË KOSOVË 2012-2016- Pasqyra e sektorit të NVM-ve në Kosovë

2.4.3 Bizneset e regjistruara në Kosovë

Sipas ARBK-së në MTI, numri i NVM-ve të regjistruara më 31 dhjetor 2010 ishte më i madh se 100.000, të cilat punësojnë 216.799 punëtorë, ose 79.59% të totalit të të punësuarve në sektorin privat dhe 62.24% të totalit të punësuarve në Kosovë. Madhësia e NVM-ve në Kosovë është e definuar me Ligjin nr. 2005/02-L5 dhe me Ligjin nr. 03/L-031 për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme. Numri i të punësuarve është kriteri i vetëm që përdoret për klasifikimin e ndërmarrjeve sipas madhësisë në Kosovë. Kjo paraqet dallimin me vendet e BE-së, ku përveç numrit të punëtorëve, merret parasysh edhe qarkullimi vjetor. Në tabelë është dhënë spektri i ndërmarrjeve të regjistruara në Kosovë në bazë të numrit të punëtorëve.

Tabela 4. Ndërmarrjet e regjistruara në Kosovë sipas numrit të punëtorëve – 2010

Klasifikimi sipas madhësisë	Numri I Punëtorëve	Numri i ndërmarrjeve	Përqindja në total
Mikro 1	1 – 9	102,070	98.37
Të vogla	10 – 49	1,406	1.35
Të mesme	50 – 249	221	0.22
Të mëdha	250 e më shumë	58	0.06
Gjithësej		103,755	100.00

Nga gjithsej 103.755 ndërmarrje: 102.070 (ose 98.37%) janë mikro-ndërmarrje; 1.406 (1.35%) janë të vogla; 221 (0.22%) janë të mesme dhe vetëm 58 (0.06%) klasifikohen si të mëdha. Mbizotërimi i madh i mikro-ndërmarrjeve ka implikime për Strategjinë për NVM. Në kuptim të zbrërthimit të sektorëve, NVM-të kryesisht janë të përqendruara në: tregti me pakicë (rreth 50%); transport, deponim dhe distribucion (14%);

produkte ushqimore, pije dhe duhan (9%); si dhe hotele dhe restorante (9%). Sipas Indeksit të Politikave për NVM 2009, shpërndarja sektoriale ka mbetur stabile me kalimin e kohës.¹⁵

Tabela 5. Ndërmarrjet e regjistruara në Kosovës sipas numrit të ndërmarrjeve - 2010

Lloji nr	Lloji i Pronësisë	Numri I ndërmarrjeve	Përqindja në total
1	Biznes individual	93,129	90.00
2	Ortakëri e përgjithshme	3,383	3.20
3	Ortakëri e kufizuar	90	0.08
4	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar	6,170	5.80
5	Shoqëri Aksionare	368	0.35
6	Ndërmarrje në pronësi të huaj	486	0.46
7	Ndërmarrje shoqërore	16	0.01
8	Ndërmarrje publike	12	0.01
9	Kooperativë bujqësore	68	0.06
10	Tjera – nën juridiksionin e AKPsë	32	0.03
Gjithësej		103,755	100.00

Bizneset Individuale në mënyrë të qartë dominojnë strukturën pronësore me 90%. Pjesa tjetër e kompanive janë ortakëri të përgjithshme (3.2%) dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (5.8%).

Sigurisht që lloji i pronësisë i paraqitur më lartë paraqet mangësitë e NVM-ve në Kosovë, sepse tregon hezitim të pronarëve të NVM-ve për bashkimin e kapitalit financiar dhe njerëzor në forma më të avancuara të biznesit.

¹⁵ STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË NVM-ve NË KOSOVË 2012-2016- Bizneset e regjistruara në Kosovë

2.4.4 NVM-të dhe sektori joformal

Ekonomia joformale pengon konkurrencën e drejtë dhe rritë kostot relative të ndërmarrjeve që operojnë në sektorin formal. Kontratat joformale të punës dhe evazioni sistematik i kontributeve të sigurimit social dobësojnë mbrojtjen e punëtorëve dhe ulin përfitimet e tyre sociale. Ka një ndikim negativ në buxhetin fiskal dhe në tërë infrastrukturën shoqërore për shkak të uljes të të hyrave dhe uljes pasuese të shërbimeve të duhura publike. Sipas raportit për “Programin e Qeverisë për Parandalimin e Ekonomisë Joformale në Kosovë për 2010-2012”, masa e përlogaritur e ekonomisë joformale sillet nga 39% deri 50% të BPV-së. Si një prej sfidave të Strategjisë për NVM është përfshirja e më shumë NVM-ve në sektorin formal. Informaliteti dobëson besimin ndërmjet NVM-ve dhe institucioneve financiare, redukton qasjen e NVM-ve në financa dhe mundësinë e tyre për të përdorur mekanizmat formal të zgjidhjes së mosmarrveshjeve. Gjithashtu dekurajon edhe investimet e huaja

Tabela 6. Qarkullimi vjetor sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe pjesës së BPV-së, 2010

Madhësia e Ndërmarrjes	Numri I Ndërmarrjeve	Qarkullimi (€)	Pjesa e BPV-së (%)
Mikro	14,968	656,885,164.33	16.79
Të vogla	1,210	667,585,914.82	17.07
Të mesme	185	369,455,655.16	9.44
Të mëdha	58	528,558,359.84	13.51
Gjithësej	16,421	2,222,485,094.15	56.81

Burimi: Raporti i Vjetor i NVM-ve 2011

Qarkullimi total i të gjitha bizneseve ishte 2.222.485.094,15 (56.81% e BPV-së).¹⁶

¹⁶ STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË NVM-ve NË KOSOVË 2012-2016- NVM-të dhe sektori joformal

3 DEKLARIMI I PROBLEMIT

Zhvillimi ekonomik në vend ka qenë një sfidë në të kaluarën, por edhe aktualisht zhvillimi ekonomik është në një gjendje jo të lakmueshme, kur merren parasysh parametrat e zhvillimit.

Kosova qëndron e fundit në listen e shteteve të rajonit sa i përket numrit të bankave të cilat operojnë në treg. Përderisa numri i bankave të cilat operojnë në shtetet e rajonit shënon një mesatare prej rreth 20 bankave, në Kosovë operojnë 8 banka komerciale. Në anën tjetër edhe përkundër rritjes së normës së kredive joperformuese, Kosova mbetet vendi me nivelin më të ulët të kredive joperformuese në rajon. (74.2%) e ndërmarrjeve raportojnë se norma vjetore e interes të paguar ka qenë prej 10-15% ndërsa afër 14% e ndërmarrjeve raportojnë të kenë paguar norma dhe më të lartë të interes. Vetëm rreth 11% e ndërmarrjeve kanë marrë kredi me norma vjetore të interes më të ulët se 11%.

Ndërsa kur analizohet në segmente të tregut kreditor, bizneset janë ato që bartin barrën kryesore të interes në kredi pasi që këto normat e interes për biznese kanë shënuar 16.7% kurse tek ekonomitë familjare 12.2%. Kalimet nga suficitet e bollshme në deficitet e thella tregojnë se Kosova po shpezon më shumë se që ka.

Një ndër problemet kryesore ekonomike të Kosovës është zhvillimi ekonomik i bazuar kryesisht në shpenzimet publike.

Kosova renditet e fundit në rajon për nga niveli i lartë i korrupsionit, me një koeficient 2.8 (0-3 janë të ranguara vendet në të cilat korrupsioni është shumë i përhapur), dhe në vendin 110-të në rangimin e gjithmbarshëm. Tri shtetet që gjenden para Kosovës në këtë rangim janë: Bolivia, Gabon dhe Indonesia, kurse tri vendet të cilat renditen pas Kosovës janë: Ishujt Solomon, Etiopia dhe Guyana.

Inflacioni, i cili po godet Kosovën, sipas njohësve të çështjeve ekonomike dhe përfaqësuesve të organizatave ekonomike në vend, është inflacion i importuar. Derisa Kosova shumicën e produkteve i importon nga tregjet ndërkombëtare, çdo ngritje e çmimeve në botë, do ta godasë edhe Kosovën. Në nivel të tregjeve ndërkombëtare kemi pasur një ngritje të çmimeve. Po ashtu, ka pasur një ndikim të madh edhe pasiguria në tregjet ndërkombëtare dhe të gjitha ato aspekte që lidhen me mallrat strategjike, siç është

edhe nafta, është e qartë se Kosova importon inflacion dhe në shumicën e këtyre artikujve kemi pasur ngritje të çmimeve, e që më pas janë reflektuar në shportën e konsumatorit. Prodhimi i energjisë në Kosovë është i monopolizuar nga “Korporata Energjetike e Kosovës” (KEK).

Duhet të vihet re që mungesa e energjise elektrike stabile ka motivuar shumë që të mbështeten në gjeneratorë si burim alternativ i energjisë. Ndotësit më të mëdhënjë që burojnë nga termocentralet janë CO₂, SO₂, NOX, O₃, grimcat e ajrit, dhe sedimentet. Gjithashtu egzistojnë edhe problemet komerciale në mbledhjen e borxhit dhe pagesës nga Kosovarët. Edhe pse ka pas një rritje relativisht të lartë të eksporteve në raportin eksport import, të cilat janë rritur nga një bazë shumë e ulët por duket të jetë largë nga korigjimi i jobalanceve tragtarë ekonomik.

Burimet e financimit paraqesin një faktor të rëndësishëm në zhvillimin e ndërmarrjeve në Kosovë e të cilat rrjedhimisht do të ndikonin në rritjen ekonomike të vendit. Mirëpo mundësia e financimit nuk është një faktor lehtësues në themelimin e bizneseve të reja apo në ngritjen e kapaciteteve të bizneseve aktuale në Kosovë. Ky pohim rrjedh nga fakti që normat e interesit të bankave komerciale të cilat janë burimi kryesor i financimit të jashtëm të ndërmarrjeve cilësohen si mjaft të larta dhe stërngarkuese për likuiditetin e ndërmarrjeve. Rreth 70 % e qytetarëve të Kosovës janë të shqetësuar me gjendjen ekonomike të vendit. Në këtë kuadër, sipas hulumtimit papunësia dhe varfëria janë perceptuar si kërcënim kryesor për qëndrueshmërinë e vendit e që janë dy nga problemet thelbësore për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Çështja e deficitit buxhetor me të cilin përballlet Kosova mund të ketë ndikuar në pakënaqësinë e qytetarëve me gjendjen aktuale në fushën e ekonomisë. Në hulumtim, një nga problemet kryesore vazhdon të mbetet shkalla e lartë e korrupsionit me të cilët përballen qytetarët. Sipas, perceptimit të qytetarëve me shkallën më të lartë të korrupsionit prijnë Korporata Energjetike e Kosovës, Doganat dhe gjyqësori.¹⁷

¹⁷ **PUNIM UDHËZUES** - FES Prishtina- SFIDAT EKONOMIKE 2011 PLUS

4 METODOLOGJIA

Në lidhje me këtë punim të diplomës më kanë ndihmuar të dhënat e entit të statistikave të Kosovës, web-faqet e disa vendeve duke përfshirë edhe të dhënat statistikore të shteteve përkatëse. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, shënimet të marra nga interneti të ekspertëve të fushës së ekonomisë, Strategjia e Industrisë, Riinvest, Barometrit Global të Korrupsionit, revista të ndryshme me informacione të freskëta dhe aktuale, të dhënat e Bankës Qendrore.

5 REZULTATET

Deficiti buxhetor duhet të mbahet brenda kornizave të lejuara të BE-së, ose 3.5% të GDP-së. *Ekonomia e vendit* duhet të fillojë të mbështetet fuqishëm në zhvillimin e sektorit privat, i cili duhet të ketë rol bartës të zhvillimit ekonomik mbarënational. Prandaj autoritetet publike në të gjitha nivelet, por edhe sektorin privat, shoqëria civile dhe pjesëmarrësit tjerë duhet të jenë të vendosur për të përmirësuar dhe për të forcuar kuadrin ligjor dhe institucional për të luftuar korrupsionin, si dhe rritjen e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore që janë të nevojshme për zbatim.

Qeveria duhet të bëjë përpjekje që të ndikojë në rritjen e prodhimi të vendit dhe që të mos varemi nga importi.

Për të mos u rrezikuar çdo herë nga ky inflacioni, institucionet e Kosovës, duhet të marrin masa në rritjen e prodhimit vendor.

Investimi në bujqësi dhe blegtori, sigurimi i teknikave të reja të menaxhmentit do të mund të rilindte industrinë e agro-pronësimit në Kosovë, deri në atë pikë që do të mund të garonte në tregjet ndërkombëtare.

Integrimi i ekonomisë në kushtet e tregtisë dhe integrimi i investimeve është esencial për të qenë konkures në treg.

Është e preferueshme që të analizohet ana e zbatimit dhe inkurajimit të tërheqjes së sektorit jo formal në drejtim të ekonomisë formale dhe të eliminohen faktorët që ndikojnë në dekurajimin e NVM-ve për të regjistruar punëtorët, qarkullimin dhe fitimin tek autoritetet e caktuara.

Duhet të bëhet përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe kulturës së ndërmarrsisë duke synuar krijimin dhe rritjen e shpejtë të NVM-ve të qëndrueshme.

6 DISKUTIME DHE PERFUNDIME

Zhvillimi ekonomik në vend ka qenë një sfidë në të kaluarën, por edhe aktualisht zhvillimi ekonomik është në një gjendje jo të lakmueshme, kur merren parasysh parametrat e zhvillimit. Megjithatë, përkundër vështirësive, krizës ekonomike globale dhe sfidave të ndryshme, bizneset kanë arritur që të mbijetojnë, të prodhojnë ose të kryejnë shërbime dhe të krijojnë një afarizëm të suksesshëm. Zhvillimi ekonomik i vendit varet edhe prej zhvillimit të sektorit privat dhe bizneseve, duke filluar prej ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe deri ato të mëdha. Zhvillimi i tyre varet prej shumë faktorëve, menaxhimit, planifikimit afarist, gjetjes së tregut, etj., mirëpo nevojitet edhe ndihma nga ana e shtetit, përmes infrastrukturës ligjore favorizuese, politikave fiskale dhe kreditimit me norma tejet të vogla të interesit. Përmes një angazhimi permanent dhe një planifikimi të mirë e detaj, ekonomia mund të zhvillohet. Përmes zhvillimit të sektorit privat ne krijojmë ndikim në zhvillimin ekonomik. Pyetja është si ta bëjmë një plan strategjik, plan aksional dhe planet e tjera të zhvillimit.

Prej vlerave që ne i gjenerojmë, si në planifikim, menaxhim, qasjen e sistemit financiar, etj., bizneset mund të arrijnë rezultate dhe të kemi një ekonomi të zhvilluar.

Nga parimet biznesore, nga parimet e partneritetit dhe përvojat e bizneseve, mund të mësojë edhe vetë shteti dhe institucionet. Me një punë të përbashkët të të gjithëve dhe me një përkushtim, ne mund të krijojmë një vend të zhvilluar.

Ne po jetojmë prej importit e jo prej eksportit, derisa vendet e tjera jetojnë prej eksportit. Prodhuesit më parë duhet ta mbushim tregun vendor, e më pas të eksportojmë. Vendet në regjion i marrin paratë tona (nga importi) dhe ne ua zhvillojmë ekonominë atyre. Produktet duhet të jenë cilësore dhe të sigurta. Për këtë duhet të plotësohen standardet dhe të shikohet konformiteti i produkteve se a janë të sigurta.

Duhet të bëhet zbatimi i ligjeve dhe të ketë politika të qëlluara fiskale, sepse me këtë do të kemi një biznes të zhvilluar dhe një ekonomi më të mirë.

7 REFERENCAT

[http://www.fes-prishtina.org/wb/media/Publications/2011/Briefing%20Paper%20-%20Economic%20Challenges%202011%20Plus%20\(Shqip\).pdf](http://www.fes-prishtina.org/wb/media/Publications/2011/Briefing%20Paper%20-%20Economic%20Challenges%202011%20Plus%20(Shqip).pdf)

http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_zhvillimin_e_NVM-ve_-_Korrik_2011.pdf

<http://www.mfa-ks.net/?page=1,119>

<http://esk.rks-gov.net/arkivi/436-enti-i-statistikes-se-kosoves-shpalli-sot-rezultatet-paraprake-te-regjistrimi-i-popullsise-2011-ne-kosove->

<http://www.mei-ks.net/?page=1,236,518>